



Republika e Shqipërisë

Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar

Addressa: Rr. "M. Muça", Pall. 46, Ap. 23, Tiranë, Albania
Tel & Fax 00355 42 263 126. Tel 00355 42 259 124, Mobile: 00355 68 27 37 989 / 00355 69 32 38 786
E-mail gjin_marku@yahoo.com, gjin_marku@hotmail.com
Web: www.pajtimi.com

Tiranë më 22 korrik 2013

Konkluzione të ekspeditës kombëtare të misionarëv të pajtimit për shkaqet e rritjes së dhunës në shoqërinë shqiptare.

Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar që nga data 6 janar ka organizuar punën me ekspeditën e pajtimit duke përfshirë edhe periudhën fushatës elektorale para e pas zgjedhore. Pa asnjë mbështetje por dhe i sulmuar për qëndrimet oponente ndaj keq qeverisjes dhe mosfunksionimit të shtetit të së drejtës, Komiteti nuk e ka ndërprerë asnjëherë punën e tij për ndalimin e vrasjeve dhe mbështetjen ndaj familjeve në nevojë. Megjithëse fenomeni i vrasjeve ruajti të njejtin intensitet si në vitin 2012, përgjatë fushatës elektorale ndodhën më pak vrasje se muajt para dhe pas kësaj fushate. Kjo erdhi për faktin se gjatë fushatës pati një mobilizim të të gjithë faktorëve që qytetarët të shmangnin përplasjet për arsye politike. Edhe ekspedita, krahas punës për mbajtjen nën kontroll të familjeve në hasmëri nxitu qytetarët për një pjesmarrje sa më të gjerë dhe të kulturuar në debatet elektorale si dhe në procesin e votimit. Nga 1221 familje të ngujuara e 3800 të fshehura nga hasmëria u bë e mundur që 260 nga familjet e fshehura dhe 47 të ngujuara të shoqëroheshin nga misionarët për në qendrën e votimit. Për shkak se kërkesa e komitetit për aplikimin e kutive të lëvizëshme të votimit u refuzua nga KQZ, shumica dërmuese e qytetarëve të përfshirë në hasmëri u privuan nga e drejta e votës. Rreth 30 000 familje të tjera që kanë konflikte toke në fshat, dhe kanë lëvizur në metropole pa e ndryshuar gjendjen civile, e kanë pasur të vështirë që të shkojnë në zonat ku kanë vendbanimin dhe regjistrimin e tyre si votues. Qytetarët e ngjuar e të fshehur nuk mundën të kishin besim për garancinë e jetës. Mosbesimi për të lëvizuar drejt qendrave të votimit të shoqëruar nga misionarët bazohej tek përvojat e hidhura të krijuara nga vrasja e Gentian Beqirit kur ai ishte në arrest shtëpie dhe ruhej nga dy oficerë të policisë, të Rolanda Dokut që kishte një urdhër mbrojtje të policisë me vendim gjykatë apo të Frederik Marku dhe djalit të tij, Jurgen Marku, që u vranës sapo kishin dalë nga komisariati i policisë ku kërkuan mbrojtje. Grupet e punës së komitetit janë të aktivizuara në 2800 fshatra, 300 komuna dhe 60 bashki. Për vitin 2013 kemi të njejtin intensitet ako më të lartë të të vrasjeve se sa në vitin 2012. Deri tani janë 78 të vrarë, 65 burra e 13 gra. 18 prej këtyre vrasjeve janë kryer brenda familjes.

Sipas përcaktimit të policisë:

Për hakmarrje e gjakmarrje janë 18 viktimat, 17 burra e 1 grua.

Për motive pronësie janë 6 viktima, 5 mashkuj e 1 femër.

Për motive të dobëta 19 viktima, 14 mashkuj e 5 femra.

Për motive nderi 2 viktima mashkuj.

Për motive xhelozie 4 viktima, 1 mashkull e 3 femra

Për motive politike 1 viktimë, mashkull

Për motive të tjera 26 viktima 23 meshkuj dhe 3 femra

Vrasje aksidentale me armë janë 2 viktima, 2 mashkuj. Por përcaktimet e këtyre vrasjeve sipas policisë kanë qenë vazhdimisht të pa bazuara, me tendencë mbulimi të së vërtetës.

Qeveria Shqiptare, ka qenë jo vetëm e pa aftë për gjetjen e alternativave që rrisin nivelin e sigurisë publike dhe të mbrojtjes së jetës së qytetarëve, por me papërgjegjshmërinë e saj e ka thelluar tendencën e krimit në shoqëri sëbashku me varfërinë. Qeveria ka qenë vazhdimisht kundër strategjisë së Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar për kultivimin e kulturës së ligjit e të parandalimit të krimit nëpërmjet bashkëpunimit të qeverisë me komunitetin, të qytetarëve me policinë dhe institucionet si dhe aplikimin e modeleve që sjellin kontroll mbi territorin e rrisin nivelin e sigurisë kombëtare. Përballë gjendjes që i ka dalë jashtë kontrollit qeveria u mjaftua kohët e fundit me miratimin e ndryshimeve në ligj që rrisin masën e dënimit tek vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje, tek vrasjet në familje si dhe tek ato për shkak të detyrës. Që nga miratimi i këtij ligji këto vrasje janë bërë më intensive. Rishikimi i ligjeve duhej të ishte një hap tjetër dhe Ministria e Drejtësisë nuk duhej të bënte asnjë propozim për ligjet mbi krimet kundër jetës e pronës pa u konsultuar me Komitetin e Pajtitimit Mbarëkombëtar sepse, siç ka vepruar deri tani, ka gabuar.

Vrasjet në Shqipëri janë krime me vetëgjyqësi, në mungesë të drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës dhe jo vrasje sipas rregullave të gjakmarrjes. Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar e ka të qartë strategjinë e tij dhe ka kërkuar që nocioni i vrasjes për gjakmarrje të mos përmendet në kod sepse gjakmarrja si term kanunor nuk ka bazë reale në kushtet e sotme të shoqërisë shqiptare. Vrasjet me vetëgjyqësi nuk janë gjakmarrje. Kjo politikë e paqartë e ligjvënësit i ka futur shoqërinë dhe institucionet e saj në qorrrokak. Qeveria në njerën anë deklaroi se nuk kemi vrasje për gjakmarrje ose ato janë shumë të pakta e në anën tjetër e rrënjës nocionin në kodin penal e në praktikën gjyqësore. Edhe kur vetë personi deklaroi se ka bërë vrasje për gjakmarrje nuk duhet pranuar sepse ky deklarim është nën një mentalitet të deformuar kanunor dhe nën degjenerimin psikologjik të personit të konfliktuar. Propozimi i Minsitrit të Drejtësisë për dënimin me mbi 30 vjet ose me burgim të përjetshëm të të personit që bën vrasje për gjakmarrje kur vrasësi i parë është i lirë ose ka bërë më pak 15 vjet burg, nuk e parandalon por e nxit vrasjen për gjakmarrje. Do ishte me vend që çdo vrasje të dënohet me burgim të përjetshëm dhe jo më pak se 30 vite burgim, për të ndaluar vrasjen për gjakmarrje dhe justifikuar dënimin e rëndë nëse ajo ndodhte. Këtu duhen specifikuar vetëm rastet kur vrasja bëhet aksidentalisht apo në rrethanat e vetmbrojtjes ekstreme. Në anën tjetër që nga momenti kur në kodin penal specifikohet vrasja për gjakmarrje vrasësit dhe mbrojtja e tyre do deklarohen të tjera rrethana. Kjo metodë e pamenduar e qeverisë nxit edhe vrasjet me pagesë. Kështu ka ndodhur edhe me ligjin për dënimin e atyre që kërcënojnë me ngujim. Pas miratimit të ligjit kundër ngujimit asnjëri prej kërcënuesve nuk deklaroi se kërkon të marrë gjak, por vetëm se nuk e fal familjen e vrasësit duke iu shmangur kështu ligjit. Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar ka përgatitur dhe do i paraqesë qeverisë së re relacionin e plotë për reformën ligjore për të eliminuar këto kontradikta në kodin penal dhe në sistemin e drejtësisë.

Dhuna në shoqërinë shqiptare, si ajo e shfaqur këto ditë ashtu dhe ajo që është mbajtur e fshehtë gjatë gjithë viteve të tranzicionit, vazhdon të ketë një intensitet të lartë që nuk ka egzistuar kurrë ndonjëherë në historinë e shqiptarëve. Numri i vrasjeve pati një rënie deri në vitin 2005, por tani është dyfishuar, ndërsa vrasja e grave është dhjetëfishuar. Stresi dhe depresioni ka mbërthyer shumicën e familjeve shqiptare jo vetëm nga rrënimi ekonomik por edhe nga dhuna në familje, vrasjet me masakrim, sulmet për grabitje dhe maskat.

Jo vetëm mediat e huaja por dhe shumë intelektualë e politikanë të paformuar ia lënë barrën e përgjegjësisë mentalitetit patriarkal të shoqërisë shqiptare duke mos dashur të pohojnë se kjo dhunë që kulmon edhe ndaj grave e fëmijëve nuk ka asnjë lidhje me mentalitetin e shqiptarëve apo me zakonet e tyre, siç deklarohen ata shpesh. Kjo dhunë, në të gjithë dimensionin e saj, është dhunë tipike e një tranzicioni barbar, i udhëhequr e i orientuar nga një politikë e keqe pa vizion e shpesh herë barbare. Shqiptarët nga një shoqëri e edukuar prej shekujsh me kulturën e ligjit e të rregullit në komunitet janë shndërruar në një shoqëri me prirje destruktive, e korruptuar, e përfshirë në krime e vetëgjyqësi pikërisht nga kjo politikë e keqe që luhet në kurriz të popullsisë duke e detyruar atë të orientohet drejt vetgjyqësisë e krimit të të gjitha llojeve.

Fotot nga Ekspedita:



Gjin Marku në ekspeditën e pajtimit



Gjin Marku në ekspeditën e pajtimit



Gjin Marku në ekspeditën e pajtimit



Gjin Marku në ekspeditën e pajtimit



Gjin Marku në ekspeditën e pajtimit



Gjin Marku në ekspeditën e pajtimit



Gjin Marku në ekspeditën e pajtimit



Gjin Marku në ekspeditën e pajtimit



Gjin Marku në ekspeditën e pajtimit

Akoma më e rëndë bëhet situata kur ballafaqohemi me zhvillimin intensiv të krimit të paraportuar në Shqipëri e ila është në nivelet më alarmante që mund të ketë një shoqëri. Shoqëria jonë në këto 23 vjet tranzicioni ka degjeneruar drejt krimit të fshehur jo vetëm nga qytetarët që janë viktima por edhe nga qeveria e cila me demagogjinë propagandistike mbulon krimet dhe korrupsionin. Vrasjet e organizuara nga shteti në periudhën midis vitit 1992-1996, ashtu si dhe ato të vitit 1997, të vitit 2008 në Gërdec dhe të vitit 2011 para kryeministrit, janë akoma të pandëshkuara. Ndërsa në vendet e Ballkanit dhe të Europës krimet e raportuara janë nga 15 deri në 40 %, në Shqipëri ky nivel është vetëm 2, 6 %. Edhe në këtë përqindje pala që ka denoncuar është penduar për shkak të mosgjetyes së drejtësisë. Rastet e dhunës së padenoncuar prej vitesh tek gratë e moshuara në Nartë apo tek gratë e masakruara javën e fundit, janë vetëm maja e aisbergut të krimit që ndodh në Shoqërinë shqiptare. Kjo ndodh sepse kultura e mosdenoncimit dhe e mosndëshkimit shfaqet sëpari tek përfaqësuesit e shtetit. Vetëm 1, 4 % e rasteve e korrupsionit në qeveri janë denoncuar, 98, 6 % e këtij korrupsioni që është zhvilluar edhe në sytë e publikut mbete i padenoncuar e i pandëshkuar. Edhe në ato pak raste kur është bërë denoncimi, ky veprim ka rezultuar të jetë bërë për rivalitet në përfitimet brenda qeverisjes.

Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëta ka vendosur që me dt 4 shtator të thërrasë kongresin e katërt të misionarëve të pajtimit ku do ketë një panoramë të plotë të situatës dhe strategjisë së tij duke shprehur se qeveria e re do bashkëpunojë për të ndryshuar gjendjen në Shqipëri. Janë të ftuar mediat dhe komuniteti ndërkombëtar që të bëjnë përpjekjet maksimale për të sjellë në vemendkjen e publikut këtë strategji të Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar i cili është i vetmi institucion me oponencë konstruktive të sinqertë ndaj keqevrisjes që punon në pavarësi të plotë nga politika për interesat e vendit dhe të integritet të shqiptarëve në Bashkimin Europian.

Tiranë më 22 Korrik 2013